



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

**V E N D I M**

**Nr.2555, datë 10.04.2015**

**Për**

**Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Iliria Telecom A sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.04.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit Iliria Telecom A sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;

3. Rregullore e AKEP nr.1516 datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”;

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e datës 9.3.2015, (nr. 436/4 Prot. i AKEP, datë 10.3.2015), “Ankim administrativ” të sipërmarrësit Iliria Telecom A sh.p.k.
2. Urdhri i Inspektimit nr. 436Prot, datë 17.2.2015; Akti i Inspektimit me nr. 436/1Prot, datë 20.2.2015; Gjoha nr. 19, datë 20.2.2015, dhe dokumentacioni bashkëngjitur kësaj praktike inspektimi;
3. Kontrata e pajtimtarit nr. 1, datë 11.8.2013, për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm, (vënë në dispozicion nga përfaqësuesi i sipërmarrësit gjatë inspektimit);
4. Korrespondenca elektronike e shkëmbyer mes palëve (njoftime me SMS);
5. Relacion shpjegues (Relacioni);

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

### I.

1. Sipërmarrësi Iliria Telecom A sh.p.k. me shkresën e datës 9.3.2015, me objekt “Ankim administrativ” drejtuar AKEP, shpjegon se, është njohur me Aktin e Inspektimit nr. 436/1 Prot., datë 20.2.2015 dhe Gjohën nr. 19, datë 20.2.2015, nëpërmjet postës më datë 4.3.2015. Në lidhje me arsyet e gjobës, Iliria Telecom A sh.p.k., pretendon se janë të pabazuara e të qëllimshme, dhe me anë të këtij ankimi, i kërkon Këshillit Drejtues të njihet me të gjitha praktikatat shkresore të depozituara në AKEP, sa i takon problemeve që ky operator ka me operatorë të tjerë të telefonisë në vend.
2. Iliria Telecom A sh.p.k. shpjegon se, duke iu referuar Aktit të inspektimit, dhe vendimit të grupit të inspektimit për dhënien e masës së dënimit me Gjohë në vlerën 300 000 (treqind mijë) Lekë, për Iliria Telecom A sh.p.k., ka këto kundërshtime:
  - Gjoha është tendencioze dhe e pabazuar ligjërisht për shkak se inspektorët janë paraqitur vetëm njëherë në zyrën e Iliria Telecom A sh.p.k., duke u mjaftuar vetëm me një komunikim të shkurtër dhe dorëzimin e kontratës nr. 1, datë 11.8.2013;
  - Inspektorët nuk e kanë shqyrtuar aspak kontratën me abonentin, që i’u është vënë në dispozicion. Nëse inspektorët do ta kishin shqyrtuar kontratën, do ta kishin kuptuar që është në përputhje me kërkesat e nenit 99, të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 31;

- Në Aktin e Inspektimit dhe Gjobën nr 19, nuk cilësohet aspak se ç'farë nuk përmban kontrata me abonentin dhe cilën nën pikë të pikës 1, të nenit 99, të ligjit nr. 9918/2008, dhe Rregullores nr. 31, nuk plotëson kjo kontratë;
3. Iliria Telecom A sh.p.k. shprehet se, duke qenë se ka probleme në komunikim, dhe nga mosveprimi i AKEP-it, ka qenë dhe është e përditësuar me çdo Rregullore, Vendim e shkresë të këtij institucioni dhe ka pasqyruar çdo ndryshim të ligjit nr. 9918/2008, në kontratat me pajtimtarin edhe pse nga AKEP nuk ka patur njoftime në lidhje me ndryshimin e ligjit.
  4. Iliria Telecom A sh.p.k. shpjegon se, kanë qenë në komunikime shkresore me AKEP në dhjetor 2013, dhe kanë thirrur abonentët për të nënshkruar kontratat e ndryshuara. Kontrata që u është dorëzuar inspektorëve, është përditësuar në dhjetor 2012 dhe pas miratimit të Rregullores nr. 31.  
Iliria Telecom A sh.p.k. shpjegon se, një nga elementët e rëndësishëm të ndryshuar në ligjin nr. 9918/2008, që prek kontratën, është neni 107, është e drejta e ankimit, (pika VII-Trajtimi i ankesave, në Rregulloren nr. 31) është pasqyruar në kontratën tip, konkretisht në: nenin 3, pika 3.1.33; nenin 4, pika 4.2.10; nenin 7, pika 7.6; Aneksin 2, pika 4, Udhëzues për zgjidhjen e ankesave;  
Për këtë, Iliria Telecom A sh.p.k. shprehet se inspektorët e AKEP nuk e kanë lexuar kontratën që i'u vu në dispozicion.
  5. Bazuar sa më lart, Iliria Telecom A sh.p.k. i kërkon Këshillit Drejtues të AKEP të shfuqizojë Gjobën nr. 19, datë 20.2.2015, për arsye se, është e padrejtë, e pabazuar në ligjin nr. 9918/2008 i ndryshuar, pa lidhje me nenin 137 të tij; Rregulloren nr. 31; dhe në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1990, datë 14.6.2012.

## II.

- Lidhur me procesin e inspektimit, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes së inspektimit (*Akt Inspektimi nr. 436/1Prot., datë 20.2.2015 dhe Relacioni nr. 436/2Prot., datë 2.3.2015*), vërehet se, me Urdhrin e Inspektimit nr. 436Prot., datë 17.2.2015, Kryetari ka udhëruar kryerjen e inspektimit në sipërmarrësin e komunikimeve elektronike Iliria Telecom A sh.p.k., me objekt verifikimin e zbatimit të:
  - Kushteve të autorizimit të përgjithshëm;
  - Rregullores për “Për portabilitetin e numrit”;
  - Rregullores për “Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”;
  - Rregullores për “Administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar dhe ndërkombëtar për interkoneksin e rrjeteve”;
  - Rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”;
  - Konformitetit të pajisjeve dhe aparaturave, sipas Rregullores nr. 25, datë 14.6.2012;
  - Rregullores “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”;
  - Rregullores për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve në RSH”;

- Në zbatim të udhrit të lartpërmendur Grupi i Inspektimit, ka njoftuar përfaqësuesin ligjor të Iliria Telecom A, z. Jetmir Nikolli, për kryerjen e inspektimit dhe e ka njohur me Urdhrin nr. 436, datë 17.2.2015, duke i kërkuar krijimin e kushteve për kryerjen e inspektimit konform nenit 12, të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”.

Grupi i inspektimit, gjatë kryerjes së inspektimit u shoqërua nga përfaqësuesi ligjor z. Nikolli, dhe në përfundim të verifikimit të zbatimit të detyrimeve të sipërmarrësit dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, ka konstatuar se:

Sipërmarrësi Iliria Telecom A sh.p.k. sipas Autorizimit Nr. 2012-AP-U77-8-18, ofron:

- Rrjete publike tokësore fikse (akses dhe transmetim)
- Shërbime publike të komunikimeve elektronike (tranzit kombëtar)

**Mbulimi me rrjet:** Iliria Telecom A sh.p.k., ofron shërbimin telefonik fiks në rrethin Tiranë për 22 përdorues familjarë, të cilët janë të regjistruar.

**Standardet /miratimit të tipit:** pajisjet e përdorura ishin të pajisura me deklaratë konformiteti.

**Tarifat:** lidhur me këtë pikë, grupi i inspektimit ka marrë deklarin nga përfaqësuesi i sipërmarrësit se, tarifat e shërbimeve bazë dhe të instalimit aplikohen të unifikuara për të gjithë përdoruesit.

**Faturimi:** përdoruesit pajisen me faturë mujore të detajuar për shërbimin telefonik fiks.

**Shërbimet e urgjencës:** sipërmarrësi ka implementuar numrat e shkurtuar të emergjencës: 127, 128 e 129.

**Shërbimet urbane/ndërrurbane:** sipas deklaratës së përfaqësuesit realizohen përmes sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me të cilin ka lidhur Marrëveshje Interkoneksioni.

**Kontrata me pajtimtarët:** grupi i inspektimit ka konstatuar se kontrata me pajtimtarët që sipërmarrësi ka aplikuar, nuk është në përputhje me Rregulloren nr. 31, datë 26.12.2013 “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”.

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:** sipas deklaratës së përfaqësuesit, nuk ka patur mosmarrëveshje. Ankesat janë zgjidhur brenda një kohe të shkurtër.

**Pajisjet e deklaruara:** Lan Desing, Data-Comm Network (connection map) sipas skemës teknike.

**Centrali telefonik:** i tipit “Sansay SBC”, instaluar në Tiranë, me kapacitet e nr. të instaluar 500. Kapacitet të rrjetit të parë 100 linja.

**Treguesit e cilësisë së shërbimit:** nga verifikimi rezulton se është zbatuar Rregullorja nr. 16, datë 16.4.2010.

**Publikimi i informacionit:** grupi i inspektimit ka konstatuar se, faqja e internetit të sipërmarrësit për shkak të problemeve teknike, nuk ishte e aksesueshme, por nga përfaqësuesi është deklaruar se ka kryer publikimin konform Rregullores nr. 27, datë 21.9.2012.

**Të dhënat statistikore/financiare:** nga verifikime u konstatua se janë në përputhje të Rregullores nr. 12, datë 7.4.2010.

- Pas verifikimeve të lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga përfaqësuesi i sipërmarrësit Iliria Telekom A sh.p.k., Grupi i inspektimit, ka konkluduar se:
  - Kontrata e pajtimtarit (*nr. 1, datë 11.8.2013, vënë në dispozicion grupit të inspektimit*) për ofrimin e shërbimit telefonik publik të qëndrueshëm, që ky sipërmarrës lidh me pajtimtarët, nuk është në përputhje me Rregulloren nr. 31, datë 26.12.2013, për “Termat e përgjithshme të kontratës së pajtimtarit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”;
  - Sipërmarrësi nuk ka vënë në funksion faqen e internetit ku pasyrohet informacioni i kërkuar sipas Rregullore nr. 27, datë 21.9.2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”.
- Sa më lart, Grupi i inspektimit, bazuar në nenin 137, të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”, ka arritur në konkluzionin se: Sipërmarrësi Iliria Telecom A sh.p.k., duke mos zbatuar pikën 1, të nenit 99 të ligjit nr. 9918/2008, ka konsumuar pikën nr. 1 të nenit 135 kundravajtjet administrative, të ligjit nr. 9918/2008.
- Për rregullimin e shkeljeve të lartpërmendura, Grupi i inspektimit i ka lënë sipërmarrësit detyrat:
  1. Të fillojë pajisjen e pajtimtarëve me kontratat sipas parashikimeve të nenit 99/1 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, brenda datës 15.3.2015;
  2. Të bëjë menjëherë funksionale faqen e internetit për pasyrimin e informacionit të kërkuar sipas Rregullore nr. 27, datë 21.9.2012.
- Në përfundim, Grupi i inspektimit, bazuar në nenin 137, pika 5, e paragrafit V, të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, për moszbatim të nenit 99/1, të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, dhe Rregullore nr. 31, datë 26.12.2013, ka vendosur: Masën administrative “Gjobë” në vlerën 300 000 Lekë (treqind mijë).

### III.

DSHLMP dhe DMFCI, pasi shqyrtuan: (1) pretendimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga sipërmarrësi, dhe (2) aktet në dosjen e inspektimit të hartuara dhe të mbledhura nga Grupi i Inspektimit, vlerëson se:

1. Ankimi i paraqitur nga Iliria Telecom A sh.p.k. më datë 9.3.2015, protokolluar në AKEP me nr. 436/4 Prot., datë 10.3.2015, është kryer brenda afatit 10 ditor të parashikuar nga Rregullorja nr. nr. 34, datë 23.12.2014 “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”, dhe është në përputhje me formën e kërkuar ligjore;
2. Grupi i inspektimit në zbatim të parashikimeve të Rregullore nr. 34, datë 23.12.2015, për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” ka kryer veprimet proceduriale duke zhvilluar procedure inspektuese.

3. Rezulton se, Grupi i inspektimit ka njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e sipërmarrësit dhe i ka dorëzuar kopjen e urdhrit nr. 436 Prot., datë 17.2.2015. Nga ana e përfaqësuesve të sipërmarrësit, grupit të inspektimit i është vënë në dispozicion materiali i kërkuar. Në vijim, të procesit të inspektimit, përfaqësuesit e sipërmarrësit nuk kanë qenë më prezent edhe pse janë njoftuar nga inspektorët.
4. Sa i takon shkeljes së kryer nga Iliria Telecom A sh.p.k. për të cilën është ndëshkuar me masën e dënimit me “Gjobë”, konstatohet se sipërmarrësi, nuk ka pasqyruar në kontratën me pajtimtarin, mënyrën dhe procedurat për zgjidhjen e ankesave të pajtimtarit sipas pikës 991, pika 1/ë, në zbatim të detyrimit të pasqyrimin të ndryshimeve të ligjit nr. 9918/2008 (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012).

Në këto procedura, duhet të ishte parashikuar në kontratë, e drejta e pajtimtarit për t’ju drejtuar AKEP-it, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me sipërmarrësin, *(si një procedurë administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e thjeshtë e shpejtë e pa kosto për pajtimtarin)*, përpara se t’i drejtohet gjykatës, sipas kërkesave të:

1. Nenit 107, i Ligjit nr. 9918/2008, “për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012.

2. Rregullores nr. 31, datë 26.12.2013, “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimin për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”, pika VIII, nënpika 7, mbi trajtimin e ankesave.

Referuar edhe nenit 99/5 të ligjit nr. 9918/2008, sipërmarrësit kanë detyrimin e hartimit të kontratës me pajtimtarin mbi bazën e legjislacionit në fuqi, dhe rregullave të nxjerra nga AKEP në zbatim të tij.

Theksojmë se, në lidhje me këtë konstatim të shkeljes, ndryshe nga sa shprehet në ankim, sipërmarrësi është i qartë sepse i ka referuar me saktësi ndryshimet që duhen reflektuar në kontratë, në paragrafin e fundit të faqes nr. 3, të pretendimeve të paraqitura.

Në lidhje me këtë shkelje, inspektorët, veç dënimit me gjobë, i kanë lënë detyrë sipërmarrësit që brenda datës 15.3.2015, të pajisë pajtimtarët me kontrata të cilat duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator si më lart përmendur. Nga shqyrtimi i materialeve mbështetëse të pretendimeve të Iliria Telecom A sh.p.k., konstatohet se, kontrata e depozituar nga sipërmarrësi në AKEP, bashkëngjitur ankimit, është e ndryshme nga kontrata që i është dorëzuar grupit të inspektimit.

5. Referuar aktit të inspektimit, pika nr. 13, në lidhje me zbatimin e detyrimeve të Rregullores nr. 27, datë 21.9.2012, “Mbi publikimin e informacionit mbi tarifatat si dhe kushtet e aksesit të përdorimit të shërbimeve” rezulton se, inspektorët nga verifikimi në vend, kanë konstatuar mosfunksionimin e kësaj faqeje. Për këtë shkelje, inspektorët kanë kërkuar vënien menjëherë në funksionim të faqes së internetit. Më datë 1.4.2015, është verifikuar se kjo faqe ende nuk është vënë në funksion.

6. Lidhur me pretendimin e Iliria Telecom A sh.p.k. për praktika të mëparshme (ankime), që ky operator ka patur me operatorë të tjerë të telefonisë në vend, dhe mosndërhyrjes së AKEP,

pas shqyrtimit të materialeve bashkëngjitur ankimit, nuk u gjet ndonjë shkresë apo dokument që ta mbështesë këtë pretendim.

7. Pas shqyrtimit të pretendimeve të sipërmarrësit Iliria Telecom A sh.p.k., arsyetimeve dhe akteve të paraqitura nga Grupi i Inspektimit, dhe nga analiza e themeltë e çështjes objekt shqyrtimi, arsyetojmë se, vendosja e masës administrative “Gjobë” (nr. 19, datë 20.2.2015) përlligjet administrativisht pasi është e bazuar në dispozitat materiale dhe proceduriale të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014, “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, dhe në nenin 146/ a, të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **V E N D O S:**

1. Lënien në fuqi të masës administrative Gjobë me nr. 19, datë 20.2.2015, të vendosur nga Grupi i Inspektimit dhe rrëzimin e ankimit të sipërmarrësit Iliria Telecom A sh.p.k., të paraqitur me shkresën e datës 9.3.2015 (*nr. 436/4 Prot. i AKEP, datë 10.3.2015*).
2. Të njoftohet sipërmarrësi Iliria Telecom A sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**